



Të nderuar përfaqësues të mediave
Të nderuar qytetarë,

Ju faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në këtë konferencë për shtyp. Kam kënaqësinë të ndaj me ju sot një lajm shumë të mirë për Republikën e Kosovës dhe në veçanti për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës. Sikurse jeni në dijeni, Republika e Kosovës ka fituar arbitrazhin ndërkombëtar ndaj institucionit financiar lute Credit.

Institucioni Mikrofinanciar lute Credit është regjistruar me datë 27 tetor 2017, me të cilin regjistrim është autorizuar të kryej veprimtari financiare të dhënies së kredive.

Përmes politikës së saj të licencimit, BQK-ja në vazhdimësi synon që të ofrojë kushte sa më të mira për qasje në financa në Kosovë, duke mundësuar operimin në tregun tonë financiar vetëm të institucioneve të cilat i kontribuojnë stabilitetit dhe zhvillimit të sistemit financiar dhe, rrjedhimisht, edhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Gjatë periudhës së operimit të lute Credit në Kosovë, ky institucion në vazhdimësi ka devijuar nga plani i biznesit, në bazë të cilit kishte marrë licencën për të operuar, duke i sjellë kështu tregut tonë diçka tjetër prej asaj që kishte premtuar.

Konform detyrave dhe përgjegjësisive lidhur me mbikëqyrjen e institucioneve financiare, BQK-ja ka kryer dy ekzaminime të fokusuara në këtë institucion mbi pajtueshmërinë e tij lidhur me operimin krahas planit të biznesit të aprovuar me rastin e regjistrimit nga BQK.

Ekzaminimet e BQK-së kishin evidentuar një varg shkeljesh të mëdha, dhe se normat e interesit që kishte aplikuar ky institucion janë jashtë çdo standardi, qoftë nëse i krahasojmë me vetë projeksionet e këtij institucioni, qoftë në raport me normat e interesit në kredi që aplikohen nga institucionet tjera financiare në vend.

Ky devijim ishte në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, dhe se, me veprimtarinë e tij kishte rrezikuar aftësinë paguese të huamarrësve dhe me këtë ka paraqitur rrezik edhe për stabilitetin financiar të vendit.

Bazuar në shkeljet e evidentuara nga ekzaminimet e njëpasnjëshme, Bordi Ekzekutiv i BQK-së, me 6 dhjetor 2019 bazuar në kompetencat që i garanton neni 36 paragrafi 1, nënparagrafët 1.11 dhe 1.12, si dhe neni 67 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së

Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 105, paragrafi 1, nënparagrafi 1.10 të Ligjit për Bankat, Institucionet Financiare dhe Institucionet Financiare Jobankare, kishte vendosur që të revokojë regjistrimin dhe të iniciojë procedurat e likuidimit për institucionin mikrofinanciar “Iute Credit Kosovo” Sh. A.

BQK-ja ka qenë dhe mbetet e sigurtë në ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e vendimeve, në raport me këtë institucion dhe të gjitha vendimeve të nxjerra nga organet ekzekutive të saj.

Institucioni në fjalë, konform të drejtës së tyre ligjore, kishte iniciuar padi pranë Arbitrazhit Ndërkombëtar, për të kontestuar ligjshmërinë e vendimit të Bordit Ekzekutiv të BQK-së.

BQK falënderon Qeverinë e Republikës së Kosovës për iniciimin e ndarjes së mjeteve monetare për mbrojtjen e Republikës së Kosovës pranë arbitrazhit. BQK po ashtu falënderon Ministrinë e Drejtësisë dhe Avokaturën e Shtetit për vendosjen e kontaktit të drejtpërdrejt ndërmjet BQK-së dhe firmës mbrojtëse për Republikën e Kosovës.

Që në fillim, kam vendosur ish zëvendësguvernatorin Sokol Havolli si bartës të këtij procesi, i cili në bashkëpunim me vartësit e tij, kanë realizuar me sukses çdo fazë në mbrojtje të Republikës së Kosovës, duke qenë edhe dëshmitari kyç pranë arbitrazhit.

Gjithashtu, shfrytëzoj rastin të përgëzoj edhe të gjithë punonjësit tjerë në BQK të cilët përgjatë gjithë procesit të punës dhe mbrojtjes kanë qenë në krye të detyrës. Besimi ynë në profesionalizmin e punonjësve në BQK nuk është luhatur asnjëherë.

Si rrjedhojë e gjithë këtij angazhimi dhe procesi profesional nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, kemi arritur që të kemi një epilog 100% në favor të vendit. Si bartës i të gjitha përgjegjësive brenda institucionit që drejtoj, ndjehem i lumtur me këtë rezultat dhe me të gjitha rezultatet e arritura përgjatë viteve. Po aq e rëndësishme sa edhe rezultati, është edhe fakti se kostot e asociuara me këtë proces do të barten nga pala paditëse. Ndjej krenari të veçantë që kam arritur përgjatë gjithë kësaj kohe, në bashkëpunim me të gjithë kolegët në BQK, të mbrojtë shtetin, qytetarin, institucionin dhe stabilitetin financiar.

Në kohë të ndryshme, jemi ballafaquar me sfida dhe sulme të orkestruara si nga brenda ashtu edhe nga jashtë, të cilat kanë pasur qëllim të dëmtojnë proceset e BQK por edhe reputacionin tim, reputacionin e BQK-së dhe të Republikës së Kosovës. Në disa raste më kanë bërë të ndjehem keq. Por asnjëherë nuk jam ndjerë se nuk po zbatoj ligjin.

Për fund, me lejon të ju informoj se Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është e përkushtuar që të krijojë kushte për rritjen e konkurrencës së shëndoshë në tregun tonë financiar, duke mundësuar një konkurrencë të drejtë ndërmjet institucioneve financiare të cilat sigurojnë rritje të qasjes në financa dhe përmirësim të kushteve, por nuk do të lejojë asnjëherë operimin e atyre institucioneve të cilat nuk zbatojnë kërkesat rregullative dhe ligjore të vendit, dhe të cilat shfrytëzojnë kushtet e vështira financiare në të cilat mund të gjendet një pjesë e qytetarëve tonë, duke sjellë shërbime të cilat i varfërojnë dhe e vështirojnë edhe më tepër jetën e tyre.